



Udhëzues për plotësimin e LIBRIT TË SHITJES

Data: Shëno datën e faturës. Formati duhet të jetë: data / muaji / viti, p.sh. 13.01.2017. Kjo rubrikë është mandatore.

Numri i faturës: Shëno numrin e faturës së shitjes. Formati është i lirë, rubrika është mandatore.

Emri i blerësit: Shëno emrin e plotë të blerësit të cilit i janë furnizuar mallra / shërbime , p.sh.. "XXXXX" SH.P.K. Formati është i lirë, rubrika është mandatore.

Numri Fiskal i blerësit / Numri Unik i Regjistrimit të Biznesit: Shëno Numrin Fiskal të blerësit apo Numrin Unik të Regjistrimit të Biznesit – blerësit. Numri Fiskal - formati është 9 shifror, fillon me 6... dhe përmban vetëm numra (p.sh. 600000001); Numri Unik i Regjistrimit të Biznesit – formati është 9 shifror, fillon me 81... dhe përmban vetëm numra (p.sh. 810000123). Kjo rubrikë validohet sipas Numrit Fiskal/ Numrit Unik të Regjistrimit të Biznesit. Nuk është rubrikë mandatore.

Numri i TVSH-së i blerësit: Shëno numrin e TVSH-së së blerësit nëse ka. Formati është 9 shifror, fillon me 3 dhe përmban vetëm numra (p.sh. 330000001). Validohet sipas Numrit të TVSH-së, nuk është rubrikë mandatore.

[9] Shitjet e liruara pa të drejtë kreditimi: Vendos shitjet e liruara pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së, sipas nenit 27 dhe nenit 28 të Ligjit për TVSH. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[10a] Shitjet e shërbimeve jashtë vendit: Vendos shitjet e shërbimeve për persona me seli jashtë Kosovës. Këtu vendosen shitjet sipas nenit 20 të Ligjit për TVSH. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[10b] Shitjet brenda vendit me ngarkesë të kundërt të TVSH-së: Vendos shitjet brenda vendit me ngarkesë të kundërt (*reverse charge*) p.sh. furnizimi i shërbimeve në lëmin e ndërtimtarisë ku obligimi për të paguar TVSH-në bartet nga furnizuesi tek pranuesi i furnizimit. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[10c] Shitjet tjera të liruara me të drejtë kreditimi: Vendos shitjet tjera të liruara me të drejtën e zbritjes së TVSH-së. P.sh. furnizimet e mallrave dhe shërbimeve sipas nenit 32, 33 të Ligjit të TVSH-së, etj. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[10] Totali i shitjeve të liruara me të drejtë kreditimi: Formati është numër; është rubrikë kalkuluese, e cila mbledh rubrikat (10a+10b+10c).

[11] Eksportet: Vendos shitjet e mallrave - eksportet sipas nenit 31 të Ligjit të TVSH-së. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[12] Shitjet e tatueshme: Vendos shitjet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve brenda vendit me normën standarde të TVSH-së prej 18%. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[16] Nota debitore e lëshuar, nota kreditore e pranuar: Shëno rastet sipas nenit 47 të Ligjit për TVSH, kur shuma e tatueshme dhe TVSH-ja në faturën tatimore duhet të korrigohet sipas nenit 41.1. të këtij Ligji. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[20] Fatura e borxhit të keq e pranuar: Shëno rastet sipas nenit 48 të Ligjit për TVSH, për faturat e borxhit të keq që lëshohen sipas nenit 43 të këtij Ligji. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[24] Rregullimet për të rritur TVSH-në: Shëno rregullimin e zbritjeve sipas nenit 41 të Ligjit të TVSH-së kur përcakton më vonë se zbritja e TVSH-së së zbritshme ka qenë më e lartë se sa shuma për të cilën personi i tatueshëm ka pasur të drejtë të zbres. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[28] Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt: Vendos shumën pa TVSH mbi bazën e të cilës llogaritet detyrimi i TVSH-së me normë standarde të TVSH-së, 18%. Këtu vendosen rastet kur obligimi për pagesë të TVSH-së bartet nga furnizuesi te pranuesi sipas ngarkesës së kundërt. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[K1] Totali i TVSH-së së llogaritur me normën 18%: Formati është numër, është rubrikë kalkuluese, e cila mbledh rubrikat (12+16+20+24+28) dhe i shumëzon me normën standarde të TVSH-së, 18%.

[14] Shitjet e tatueshme: Vendos shitjet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve brenda vendit me normën e reduktuar të TVSH-së, 8%. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[18] Nota debitore e lëshuar, nota kreditore e pranuar: Shëno rastet sipas nenit 47 të Ligjit për TVSH, kur shuma e tatueshme dhe TVSH-ja në faturën tatimore duhet të korrigohet sipas nenit 41.1. të këtij Ligji. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[22] Fatura e borxhit të keq e pranuar: Shëno rastet sipas nenit 48 të Ligjit për TVSH, për faturat e borxhit të keq që lëshohen sipas nenit 43 të këtij Ligji. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[26] Rregullimet për të rritur TVSH-në: Shëno rregullimin e zbritjeve sipas nenit 41 të Ligjit të TVSH-së kur përcakton më vonë se zbritja e TVSH-së së zbritshme ka qenë më e lartë se sa shuma për të cilën personi i tatueshëm ka pasur të drejtë të zbres. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[K2] Totali i TVSH-së së llogaritur me normën 8%: Formati është numër, është rubrikë kalkuluese, e cila mbledh rubrikat (14+18+22+26) dhe i shumëzon me normën e reduktuar të TVSH-së, 8%.

[30] Totali i TVSH-së së llogaritur me 18% dhe 8%: Formati është numër, është rubrikë kalkuluese, e cila mbledh rubrikat (K1+K2).